



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-160

PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL

KREU I
DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ministria** - Ministria e Punëve të Brendshme;
- 1.2. **Ministër** - Ministri i Punëve të Brendshme;
- 1.3. **Agjencia** - Agjencia e Regjistrimit Civil;

1.4. **Kryeshefi** - Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Regjistrimit Civil.

KREU II

AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL

Neni 3

Themelimi dhe Statusi i Agjencisë

1. Agjencia e Regjistrimit Civil themelohet si agjenci në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
2. Agjencia e Regjistrimit Civil është person juridik;
3. Selia kryesore e agjencisë është në Prishtinë.

Neni 4

Parimet

Agjencia e Regjistrimit civil ushtron veprimtarinë e saj sipas parimeve themelore të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil

Neni 5

Simbolet e Agjencisë

Agjencia e ka stemën e cila propozohet nga kryeshefi i Agjencisë dhe miratohet nga Ministri.

Neni 6

Udhëheqja e Agjencisë

Agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili për menaxhimin dhe administrimin e Agjencisë i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit.

Neni 7

Kryeshefi i Agjencisë

Emërimi, mandati, lirimi dhe shkarkimi i Kryeshefit të Agjencisë bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për Pozitat të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 8

Funksionet e kryeshefit të Agjencisë

1. Kryeshefi i Agjencisë është përgjegjës për:
 - 1.1. menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të Agjencisë
 - 1.2. organizimin e Administratës, punësimin e personelit dhe dhënien e urdhrave për punë nëpunësve civilë të Agjencisë;
 - 1.3. marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me detyrat e Agjencisë
 - 1.4. menaxhimin efektive dhe efikas të resurseve që i janë besuar agjencisë;
 - 1.5. përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore mbi punën e agjencisë të cilat raporte i dorëzohen ministrit;
 - 1.6. zhvillimin e planit vjetor dhe planit strategjik afatgjatë për administrimin efektiv dhe efikas të agjencisë.

Neni 9

Personeli i Agjencisë

Personeli i punësuar në Agjenci e ka statusin e nëpunësve civil.

KREU III

ORGANIZIMI STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË

Neni 10

Organizimi dhe struktura

Organizimi dhe struktura e brendshme e Agjencisë rregullohet me akt nënligjor nga ministri.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë si në vijim:
 - 1.1. përgjigjet për të gjitha proceset në lidhje me aplikimin personalizimin dhe lëshimin e dokumenteve për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e huaj;
 - 1.2. bën regjistrimin e automjeteve dhe lëshimin e patentë shofereve;

1.3. administron dhe mirëmban bazën e të dhënave të regjistrit qendror të gjendjes civile;

1.4. bashkëpunon me autoritetet e shteteve të huaja lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e saj;

1.5. bën propozimin dhe iniciimin e nxjerrjes apo plotësimit dhe ndryshimit e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fushëveprimi i sajë;

1.6. ofron shërbime profesionale dhe efikase për të gjithë qytetarët;

1.7. kryen punë dhe detyra të tjera që janë në kompetencë të agjencisë.

Neni 12 **Buxheti i Agjencisë**

1. Buxheti i agjencisë është vije buxhetore e në kuadër të buxhetit të ministrisë, të miratuar në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

2. Kryeshefi i Agjencisë përgatit buxhetin e Agjencisë, të cilin pastaj ia përcjell ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj.

3. Kryeshefi i Agjencisë është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe efikas të buxhetit të Agjencisë, në pajtim me ligjin dhe me rregullat e brendshme buxhetore të Ministrisë.

4. Të hyrat buxhetore që krijohen nga veprimtaria e Agjencisë derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

KREU IV **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 13 **Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 17/2010 për Organizimin dhe Strukturimin e Agjencisë për Regjistrim Civil si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-160
14 shkurt 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI